



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.08.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Ri-Tender-Furnizim me automjet tereni për njësinë e zjarrfikëseve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8184-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-039 -121, **nxjerr:**

### V E N D I M

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: "D & T Group" SH.P.K., e dt. 21.08.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri-Tender-Furnizim me automjet tereni për njësinë e zjarrfikëseve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8184-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-039 -121, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK -së, të datës 03.08.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirsohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, i publikuar me datë: 03.08.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirsimin e dosjes së tenderit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K.me dt.21.08.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Furnizim me automjet terreni për njësinë e zjarrfikëseve", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-8184-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-039 -121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirsimin e dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;